



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
CDLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.966/16

NË EMËR TË POPULLIT

Më  
Data

31.07.2017

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari Ilir Bytyqi, me zytare ligjore Kadishe Shabani në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] ë K. [REDACTED], për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr.75/16 te datës 07.10.2016, në praninë e përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit [REDACTED] pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt. 20.06.2017, mori dhe publikisht shpalli, kurse me datë 28.06.2017, përpiloi me shkrim këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:** [REDACTED] i lindur me [REDACTED] në Fsh. [REDACTED] K. [REDACTED] me vendbanim në të njëtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, me profesion moler, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

me datën 29 Prill 2016, rreth orës 15:30, Fsh. [REDACTED] K. [REDACTED] ka mbajtur në posedim armën në kundërshtim me ligjin mbi armët, në atë mënyrë që me rastin e kontrollit nga ana e policisë në shtëpinë e të pandehurit kanë gjetur një revole të çmontuar me numër serik [REDACTED] e cila edhe është sekuestruar përkohësisht nga policia.

**me të cilën kreu veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së**

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 3,6, 17,21,41,43,45,46, dhe 73, 74 të KPRK-së si dhe nenin 365 dhe 359 të KPRK –së, të pandehurin e :

## GJYKON

**DËNIM ME GJOBË NË LARTËSI PREJ 400 Euro (katërqind)**, të cilën gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Ne rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobë do të zëvendësohet në dënim burgu, ashtu që për çdo 20 euro do të llogaritet /1/ një ditë burgim.

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme revolja, me numë serik [REDAKTUAR].

Në bazë të nen. 450 par.1 dhe par. 2 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.75/16 të datës 07.10.2016 ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.06.2017, në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit Valdet Avdiu, mbeti në tërsi pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallet fajtorë që me rastin e matjes së dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I pandehuri [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat, më vjen keq për këtë vepër

penale, i kërkoj falje gjykatës dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla as vepra të tjera, është hera e parë që un ndeshem me ligjin andaj dhe i propozon gjykatës që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit Valdet Avdiu, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë,
  - pranimi i fajit bëhet vullnetarisht nga i pandehuri,
  - pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materiale e prezantuar nga prokurori i shtetit si dhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve i dt. 29.04.2016, vërtetimi mbi bastisjen e shtëpisë, zinxhiri i ruajtjes dt. 29.04.2016, deklarata e të pandehurit S [REDACTED] dt. 29.04.2016, si dhe shikimi i fotografive që gjenden në shkresat e lëndës.
- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ( *nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe gjyqtari vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose

shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer e që këto rrethana i ndërlidhi me faktin se i akuzuari deri tani nuk ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, në rastin konkret gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme, me numë serik [REDACTED]

Në bazë të nen. 450 par.1 dhe par.2 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.


Nga arsyet e sipërcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

#### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P.nr.966/16 me datë 28.06.2017**

**Zyrtare Ligjore**

Kadishe Shabani 

**Gjyqtari: Ilir BYTYQI**



**Këshilla juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh, Gjykatë së Apelit në Prishtinë përmes Gjykatës Themelore në Ferizaj.